



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 21448 Prot.

Lezhë, më 24 . 12 . 2021

VENDIM

Nr. 171 , Datë 23 . 12 . 2021

PËR DISA NDRYSHIME NË VKB-NË NR.119, DATË 29.07.2021 “PËR SHPALLJEN E ZGJEDHJEVE PËR KRYESITË DHE KRYETARËT E FSHATRAVE”, TË NDRYSHUAR ME VKB-NË NR.129, DATË 30.08.2021”

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; neni 8, neni 53, neni 54 dhe pikës 4 të nenit 70, Vendimit të Këshillit të Bashkisë Lezhë nr.11., datë 26.08.2020 “Për miratimin e lagjeve në fshatra, zgjedhjen e anëtareve të kryesisë dhe të kryetareve të fshatrave në Bashkinë Lezhë”, të ndryshuar, VKB-në nr.119, datë 29.07.2021 “Për shpalljen e zgjedhjeve për Kryesitë dhe Kryetarët e fshatrave”, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

VENDOSI:

- Miratimin e disa ndryshimeve në Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.119, datë 29.07.2021 “Për shpalljen e zgjedhjeve për Kryesitë dhe Kryetarët e fshatrave”, të ndryshuar me VKB-në nr.129, datë 30.08.2021, si më poshtë:
 - Në pikën 2 të VKB-së nr.119, datë 29.07.2021, i ndryshuar, bëhet ndryshimi si më poshtë:
 - Afati i përfundimit të procesit të zgjedhjeve për kryesitë dhe kryetarët e fshatrave të përcaktuara në pikën 1 të VKB-së nr.119, datë 29.07.2021, i ndryshuar, shtyhet deri me datë 28.02.2022.
 - Në pikën 3 të VKB-së nr.119, datë 29.07.2021, i ndryshuar, bëhet ndryshimi si më poshtë:
 - Zhvillimi i zgjedhjeve për fshatin Ungrej, Njësia Administrative Ungrej, të ndiqet nga anëtarët e Këshillit Bashkiak, Gjin Kola, Ernest Rakaj, Emirjan Lazri, Ndue Luli, Kristjan Leka.
 - Zhvillimi i zgjedhjeve për fshatin Mali i Rrencit, Njësia Administrative Shengjin, të ndiqet nga anëtarët e Këshillit Bashkiak, Ardian Marku “Nikulaj”, Brahim Demi, Rigels Nicaj, Regjina Sokolaj, Edlir Reçi.
- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Këshilli i Bashkisë Lezhë.
- Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
ERNEST RAKAJ

